



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:082332

Datë: 04.12.2023

Numri i dokumentit: 05009291

P.nr.1577/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit A.R. nga Prishtina, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së, me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm për dhënien e urdhrin ndëshkimor me numër PP/II.nr.1253/2023, të datës 29.03.2023, pas konstatimit se të dhënat në aktakuzë ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor me datë 04.12.2023 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit të shtetit, PP/II.nr.1253/2023, e datës 29.03.2023, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPP-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: A.R., nga babai N. dhe nëna K., e gjinisë L., i lindur me datë, në Prishtinë, me adresë të banimit në rrugën “.....”,,, nr.41, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me profesion saldues, ka të kryer shkollën fillore, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 03.10.2022 rreth orës 17:20, në qendrën tregtare “Viva Fresh Store” e cila gjendet në rrugën “Dëshmorët e Kombit” në Prishtinë, i pandehuri A.R. me dashje e me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj ka vjedhur produkte ushqime të dëmtuarit subjektit “Viva Fresh Store” në atë mënyrë që, ka hyrë brenda në market dhe ka vjedhur shtatë pako kafe, të llojit princ me peshe prej 500 gram, në vlerë të përgjithshme prej 40.25euro, duke

vazhduar tutje pa i kryer pagesat, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëmin material në lartësi rreth 40.25 euro,

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së,

Andaj, gjykata konform neneve 4; 38; 39; 40; 43; 69; 70; të KPRK-së, si dhe neneve 364 dhe 495 të KPP-së, të pandehurit:

I CAKTON

I. Dëmin me gjobë shumë prej 200 € (dyqind euro), të cilin dënim i pandehuri obligohet që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Nëse i pandehuri nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës, do t'i caktohet 1 (një) ditë burgim.

III. E dëmtuara "Viva Fresh Store (pika numër 35)" – në rrugën Dëshmorët e Kombit Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

IV. Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (njëzet euro), si dhe shumë prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1253/2023, të datës 29.03.2023, kundër të pandehurit A.R. nga Prishtina, për shkak të veprës penale: Vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 të KPRK-së dhe njëherit ka propozuar që ndaj të njëjtit të jepet Urdhër Ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, që vërtetojnë faktin se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata pas shikimit dhe analizimit të aktakuzës përkatëse dhe shkresave të lëndës së bashku me kërkesën për dhënie e urdhrit ndëshkimor gjeti se në këtë çështje penalo juridike janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPP-së për dhënie e urdhrit ndëshkimor dhe komfor nenit 495 paragrafi

1, 2 dhe 3 të KPP-së vendosi që të pranojë kërkesën e lartcekur dhe të pandehurit ti shqiptoj dënim unik me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë si dhe provat e bashkëngjitura në të ofrojnë bazë të mjaftueshme për një gjë të tillë dhe deri tek një konstatim i tillë gjykata erdhi duke u bazuar edhe në shkresat e lëndës siç janë provat personale dhe materiale të bashkëngjitura si foto-dokumentacioni i siguruar nga kamerat e sigurisë në vendin e ngjarjes, nga deklarata e dëshmitarit A. S., nga vet deklarata e të pandehurit e dhënë në polici, si dhe shkresat tjera në lëndë, dhe rrjedhimisht bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë mund të arrihen qëllimet e dënimit nga neni 38 i KPRK-ës.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u mor komfor nenit 449 par.1 dhe 2 pika 2.6 të KPP-së ndërkaq vendimi për shumën e të hollave në emër të Fondit për mbrojtjen e viktimave është marrë konform nenit 36 par.3, nënpar.3.1 të Ligjit nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest juridiko – civil, gjykata e mori në bazë të nenit 462 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë në bazë të neneve 364 dhe 495 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr. 1577/23, me datë 04.12.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dibran Jusufi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 (tetë) ditësh nga dita e pranimit të tij. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.